



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/250
Datë: 07.03.2025

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

- Miratohet lista e aplikimeve për rundin 10B të granteve investuese të Kornizës Investuese të Ballkanit Perëndimor (WBIF), për projektet si në vijim:
 - Aplikimi për grant investues për projektin "Impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Podujevë"; dhe
 - Aplikimi për grant investues për projektin "Përmirësimi i rrjetit të transmisionit VII".
- Obligohet Zyra e Bashkëpunimit për Zhvillim për koordinimin e procesit të finalizimit dhe dorëzimit të aplikimeve në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministrinë e Ekonomisë, dhe institucionet e tjera përfituese si dhe me institucionet financiare ndërkombëtare që janë mbështetëse të projekteve, në pajtim me kriteret dhe metodologjinë e përcaktuar në kuadër të thirrjes për aplikime në rundin 10B të granteve të investuese të Kornizës Investuese të Ballkanit Perëndimor (WBIF).
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/250
Datë: 07.03.2025

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr.02/39 të datës 3 qershor 2020

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 02/39 i datës 3 qershor 2020, si në vijim: Shfuqizohet pika 2. e Vendimit të lartcekur.
2. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe të gjitha institucionet kompetente të ndikuara për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr.02/39 të datës 3 qershor 2020.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/250
Datë: 07.03.2025

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafit 2. të Ligjit Nr.04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

- Aprovohet në parim Nisma për amendamentimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për grantin e realizimit të projektit "Mbështetje për Sistemin Shëndetësor të Kosovës".
- Obligohet Ministria e Shëndetësisë që të zhvillojë negociata me Ambasadën Italiane në Republikën e Kosovës, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të Marrëveshjes, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/250
Datë: 07.03.2025


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063, Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 14 paragrafit 1 dhe nenit 15 paragrafit 2 të Ligjit Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2025, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 6,740,000.00 Euro, për përmbushjen e detyrimit sipas vendimit të arbitrazhit për rastin ICSID Case No. ARB/17/25, Mabco Constructions, për pagesën si në vijim:
 - 1.1 5,311,560.05 euro në emër të dëmshpërblimit dhe kamatës (paragrafi 371 dhe 372);
 - 1.2 367,944.00 euro dhe 33,073.50 CHF në emër të kostos së përfaqësimit (paragrafi 373);
 - 1.3 1,104,312.20 USD në emër të kostos së arbitrazhit (paragrafi 374).
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi merren, si në vijim:
 - 2.1 Nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve me kod 201, merret shuma 3,000,000 €, nën-programi "Kontigjencat në Ministrinë e Financave", me kod 28900, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere";
 - 2.2 Nga "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 232, nga nën-programi "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 13100, kategoria e shpenzimeve "Rezerva" merret shuma prej 3,012,000.00 € dhe nga kategoria e shpenzimeve "Investime Kapitale" nga projekti "Shpenzimet e Paparashikueshme 2019-2023" me kod 13255, merret shuma prej 728,000.00 €.
3. Mjetet nga pika 2. të këtij vendimi transferohen në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, në nën-programin "Thesari" me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
4. Autorizohet Thesari që të realizoj transferin e mjeteve buxhetore sipas këtij vendimi në llogarinë e Mabco Constructions SA, shumë prej 5,679,504.05 Euro, shumë prej 33,073.50 CHF dhe shumë prej 1,104,312.20 USD, sipas kursit zyrtar valutor.
5. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë